



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 14-020/05-25356/25, më 14 FEB 2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, dhe të Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit, Kryetari i Kryeqytetit, nxjerr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet caktimi i koordinatorit të Komitetit Komunal Veprues të Kryeqytetit.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, koordinatorë caktohet znj. Klaudia Mula.
- III. Koordinatori i KKV-së do të veprojë si zyrtar përkatës në Kryeqytet për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit.
- IV. Detyrat e koordinatorës së cekur në pikën II të këtij Vendimi, janë: koordinon takimet vjetore të KKV-së, vepron si pikë komunale e kontaktit për ministrinë e linjës dhe ZQM-së për çështjet që kanë të bëjnë me Strategjinë dhe Planin e veprimit të nivelit qendror dhe situatën e komuniteteve rom dhe ashkali në përgjithësi, përpilon raportet vjetore për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të nivelit qendror, si dhe PLV-së komunale dhe prezanton në Kuvendin e Kryeqytetit, dërgon raportet e miratuara për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të nivelit qendror, si dhe PLV komunal në ZQM/ZKM.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Znj. Klaudia Mula;
- ZQM/ZKM;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

